



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

---

Numri i lëndës: 2021:074898  
Datë: 04.04.2024  
Numri i dokumentit: 05546870  
K.DH.SH.II.nr.1020/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Gashi Ing” shpk, me seli ne Suharekë rr.”Nebih Hodo Kuçi”, me numër unik 811280403, kundër debitorit Komuna e Malishevës, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1183/22 dt.08.05.2023, me datën 04.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Malishevës ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 1183/22 dt.08.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 1183/22 dt.08.05.2023, ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Malishevës, ndërsa ka lënë ne fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.103/21 dt.23.03.2021, te lejuar nga Përmbartuesja Private Saranda Kuçi për territorin e Gjykatës Themelore ne Prizren.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës kontestimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe Gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar dhe çështjen ta kthej ne rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Gashi Ing” shpk, me seli ne Suharekë rr.”Nebih Hodo Kuçi”, me numër unik 811280403, më datën 23.03.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Komuna e Malishevës, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave me nr.20/2020 dt.05.10.2020 dhe nr.22/2020 dt.05.10.2020. Përmbartuesja Private Saranda Kuçi-Prizren, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.103/21 dt.23.03.2021, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga faturat t’i paguaj shumën prej 11,364.86 euro, me kamatë prej 8% nga dita e arritjes se kërkesës për pagesë si edhe shpenzimet e procedurës se përmbartimit.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 31.03.2021 duke e kundërshtuar urdhrin për përmbartim me arsyetimin se fatura e papaguar është 10% e kontratës për ndalesë ne bazë te Ligjit për Prokurim Publik dhe kreditori nuk ka ofruar fletgarancione për këtë shumë. Ne kushtet e përgjithshme te kontratës kreditori duhet te pres 12 muaj pas përfundimit te pranimit teknik sipas nenit 2.1 te kontratës, propozon qe gjykata urdhrin përmbartimor ta refuzoj si te pabazuar.

Përgjigje ndaj prapësimit te debitorit ka ushtruar kreditori me datën 01.04.2023, duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit ne prapësim si janë te pabazuara dhe janë vetëm arsye për zvarritjen e procedurës, propozimi për përmbartim nuk i ka tiparet e përmbartueshmërisë duke u bazuar ne nenin 27 te LPP, debitori nuk ka ofruar asnjë provë ne mbështetje te pretendimeve te tij, propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta obligoj debitorin ti paguaj shpenzimet e procedurës.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1183/22 dt.08.05.2023, me të cilin e ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Ka arsyetuar, se faturat mbi bazën e te cilave është lejuar përmbartimi janë dokument te besueshme dhe i përmbajnë te gjitha elementet e kërkuara ne përputhje me nenin 29 dhe 37 te LPP dhe ne baze te tyre mund te caktohet përmbartimi. Këto fatura kane tiparet e dokumentit te besueshme sepse përmbajnë te gjitha te dhënat e kërkuara me ligj, janë pranuar nga debitori, janë dorëzuar ne origjinal gjë qe vërtetohet nga vula e pranimit dhe numri i protokollit. Pra nuk ekziston asnjë nga bazat ligjore për anulimin e lejimit te përmbartimit, andaj edhe ka vendosur si ne dispozitivi te vendimit te saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave nr.20/2020 dt.05.10.2020 dhe nr.22/2020 dt.05.10.2020 te lëshuara nga kreditori te cilat propozimit për përmbartim i janë bashkangjitur ne origjinal dhe ne pajtim me nenin 37 te LPP i cili parasheh qe *“kur propozimi për përmbartim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton qe propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë ne origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Këto fatura po ashtu janë te nënshkruara nga debitori dhe te vulosura me vulë te protokollit nr.03/2173 dhe 03/2174 dt.05.10.2020 nga organi kompetent i debitorit Komuna e Malishevës si Institucion

Publik, element ky bazë që shpreh vërtetësinë e një dokumenti, se i njëjti është pranuar në mënyrë të rregullt dhe që kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm konform nenit 29 të LPP-së dhe si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit, sepse i përmbar elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të këtij neni, i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Prandaj, bazuar në këto arsye, Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Edhe Gjykata e shkallës së dytë analizoi pretendimet e debitorit, mirëpo vlerësoi se këto pretendime nuk janë relevante për një vendosje tjetër nga çka vendosur gjykata e shkallës së parë ashtu që të njëjtat i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërtetoi.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore mbi bazën e parimit të rigorozitetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmbar aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.1020/23, me datë 04.04.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova